

VENDIM
Nr. 456, datë 31.7.2025

PËR PËRCAKTIMIN E INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE, TË PROCEDURAVE TË MIRATIMIT DHE TË DOKUMENTACIONIT QË DUHET TË PLOTËSOJNË FAMILJET QË PËRFITOJNË KREDI ME INTERES TË BARABARTË ME 0%, TË SUBVENCIONUAR NGA BUXHETI I SHTETIT, NËPËRMJET ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 47/1, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e institucioneve përgjegjëse, të procedurave të miratimit dhe të dokumentacionit që duhet të plotësojnë:

a) familjet që banojnë si qiramarrës në ish-pronë private, sipas aktit normativ nr. 3, datë 1.8.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për lirim të banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara”, të miratuar me ligjin nr. 82/2012;

b) familjet e punonjësve të Policisë së Shtetit të rënë në detyrë;

c) fëmijët në përkujdesje të Republikës.

2. Masa e subvencionit të interesave të kredisë për familjet e parashikuara në pikën 1, të këtij vendimi, për banesa me kosto të ulët, është me 0 (zero) % interes.

3. Aplikimi për përfitimin e kredisë me interes 0% kryhet nga kryefamiljari/kujdestari ligjor në portalin qeveritar “*e-Albania*”, në sistemin e Entit Kombëtar të Banesave, duke ngarkuar vërtetimin negativ nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, që në emër të kryefamiljarit dhe anëtarëve të tjerë të familjes nuk figuron, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pronë e regjistruar ose në proces regjistrimi ose vërtetimin për një pronë që është nën normat e banimit.

3/1. Familjet qiramarrëse në ish-pronë private, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 3, të këtij vendimi, ngarkojnë edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

a) autorizimin ose dokumentin e lëshuar nga ish-Komiteti Ekzekutiv i lagjes/Këshilli Popullor i lagjes, nëse disponon;

b) certifikatën apo vërtetimin e pronësisë në favor të pronarit ose vendimin e gjykatës, në të cilin vërtetohet se prona i është kthyer pronarit të ligjshëm dhe qytetari është i pastrehë;

c) vërtetimin negativ nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës përkatëse, që, në emër të kryefamiljarit dhe anëtarëve të tjerë të familjes, sipas certifikatës së gjendjes familjare, të datës 1.12.1992, nuk figuron banesë e regjistruar ose në proces regjistrimi;

ç) vërtetimin nga organet tatimore se asnjë anëtar i familjes, që përfiton kredi të lehtësuar, nuk është subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar, si biznes i madh;

d) certifikatën e gjendjes familjare të datës 1 dhjetor 1992.

3/2. Me kërkesë të Entit Kombëtar të Banesave, Ministria e Brendshme i përcjell EKB-së dokumentacionin që vërteton statusin e familjes aplikuese si familje e punonjësit të Policisë së Shtetit të rënë në detyrë.

3/3. Për fëmijët në përkujdesje të Republikës, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 3, të këtij vendimi, kërkuesit ngarkojnë edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Certifikatën personale të fëmijës me fotografi të tre muajve të fundit ose fotokopje të dokumentit të identifikimit;

b) Fotokopjen e dokumentit të identifikimit të familjarit, kujdestarit ose përfaqësuesit ligjor të fëmijës;

c) Prokurën e posaçme, në rastin kur kërkuesi është i ndryshëm nga përfaqësuesi ligjor i fëmijës.

4. Individët/familjet e miratuara për të përfituar kredi me interes 0 (zero) % qëndrojnë në listë pritjeje pa afat kohor të caktuar.

5. Lista e familjeve, që plotësojnë kushtet për të përfituar kredi me interes 0 (zero) %, miratohet me vendim të komisionit *ad-hoc* të kredisë, të ngritur pranë EKB-së. Komisioni *ad-hoc* ngrihet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Entit Kombëtar të Banesave, brenda 5 (pesë) ditëve nga paraqitja e kërkesave. Komisioni shqyrton kërkesën brenda 10 (dhjetë) ditëve nga ngritja e tij. Ndaj vendimit të refuzimit të komisionit, kërkuesit paraqesin ankim administrativ pranë EKB-së brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi i vendimit, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

6. Listat e përfituesve përfshijnë të dhëna për përbërjen e familjes, sipas certifikatës familjare, strukturën e apartamentit që përfiton, si edhe të dhëna mbi gjendjen:

a) e strehimit;

b) familjare;

c) sociale.

7. Procedura e dhënies së subvencionimit të interesave të kredisë zbatohet nga institucionet financiare me të cilat ministria përgjegjëse për strehimin ka lidhur marrëveshje. Në rastet kur kryefamiljari, emri i të cilit i është përcjellë institucionit financiar, në rastin e familjeve qiramarrëse në ish-pronë private, ka ndërruar jetë, institucioni financiar vijon me procedurat e përfitimit të kredisë, duke pasur parasysh certifikatën familjare të datës 1 dhjetor 1992, të vënë në dispozicion nga EKB-ja.

8. Listat e familjeve përfituese të programit të subvencionimit të interesave të kredisë me 0 interes i dërgohen institucionit financiar me të cilin është nënshkruar marrëveshja, si dhe çdo institucioni që do të monitorojë subvencionimin.

9. Enti Kombëtar i Banesave, në rolin e institucionit që zbaton programin, njofton institucionin financiar për ndërprerjen e subvencionimit të interesave të kredisë kur, nga verifikimet konstatohen:

a) se qytetari nuk ka liruuar banesën e pronarit brenda afatit të përcaktuar;

b) falsifikime të dokumenteve apo deklarata të rreme;

c) mangësi apo të meta në dokumentacionin e dosjes së familjes përfituese.

10. Shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 18, pika 26/1, shkronjat “a”, “b”, dhe “c”, të pikës 28/1, dhe shkronja “a”, e pikës 36, të vendimit nr. 453, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti me përzgjedhjen e institucionit financiar që do të kreditojë familjet”, të ndryshuar, shfuqizohet.

11. Ngarkohen Enti Kombëtar i Banesave, ministria përgjegjëse për strehimin, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme dhe institucionet financiare me të cilat janë nënshkruar marrëveshje për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku